



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 411 prot.

Shkodër, më 01.04. 2026

**VENDIM**

**Nr. 23, datë 30.03.2026**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 8, DATË 26.01.2026, TË KËSHILLIT  
BASHKIAK SHKODËR “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE  
VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR INDIVIDË/FAMILJE QË NUK  
PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË, PËR VITIN 2026”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; të nenit 39, pika 3, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar; të VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituruar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; të VKM nr. 362, datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; të VKM nr. 459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”; të Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitim të fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”; të VKB nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar; të VKB nr. 62, datë 31.10.2025 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”; të shkresës me nr. 924/2 prot., datë 17.12.2025, “Mbi shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së NJEF dhe qarqeve për vitin 2024, sipas INSTAT”; të VKB nr. 25, datë 13.09.2023 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social”; të VKB nr. 8, datë 26.01.2026 “Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit ‘Banesa sociale me qira’ për instrumentin financiar ‘Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë’ për vitin 2026”; të procesverbalit të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër me nr. 5617/2 prot., datë 12.03.2026; si dhe pas shqyrtimit të relacionit dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

## VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 26.01.2026, “Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit ‘Banesa sociale me qira’, për instrumentin financiar ‘Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë’ për vitin 2026”, në pikën 1 të tij, sipas tabelës së ndryshuar, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pika 3 e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 26.01.2026, ndryshohet si më poshtë:  
**Ishte:**  
“Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1, në shumën totale 20,000,391 (njëzet milion e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë, do të përballohen nga fondi i buxhetit të shtetit (grant i kushtëzuar), me bashkëfinancim të Bashkisë Shkodër, që do të jetë jo më pak se 40% e vlerës totale, konkretisht në vlerën 8,000,156 (tetë milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë dhe nga buxheti i shtetit në vlerën 12,000,235 (dymbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë.”  
**Bëhet:**  
“Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1, në shumën totale 18,733,058 (tetëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e tetë) lekë, do të përballohen nga fondi i buxhetit të shtetit (grant i kushtëzuar), me bashkëfinancim të Bashkisë Shkodër, që do të jetë jo më pak se 40% e vlerës totale, konkretisht në vlerën 7,493,223 (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë dhe nga buxheti i shtetit në vlerën 11,239,835 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë.”
3. Pikat e tjera të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 26.01.2026, mbeten të pandryshuara.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 35 vota

Vota Pro	35
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	31.03.2026

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

